



VENDIM

Nr. 43 Datë 28.05.2009

PËR

**MIRATIMIN E TRANSFERIMIT TË ASETEVE NGA SHOQËRIA
KORPORATA ENERGJITIKE SHQIPTARE SH.A. TEK SHOQËRIA
OPERATORI I SISTEMIT TE SHPËRNDARJES SH.A.**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 20 pika "1", të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", të ndryshuar, duke qënë se "Rregullorja për Procedurat e Transferimit të Aseteve nga të Licensuarit", nuk zbatohet në këtë rast (sipas nenit 4 pika 3), Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 28.05.2009, mbasi shqyrtoi kërkesën për miratimin e transferimit të asetëve nga shoqëria Korporata Energjitike Shqiptare sh.a. tek Shoqëria Operatori i Sistemit te Shpërndarjes sh.a. të miratuara me VKM Nr. 969, datë 02.07.2008 "Për Miratimin e Listës së Inventarit të Pronave të Palujatshme Shtetërore të cilat kalojnë në Administrim të OSSH sh.a.", VKM Nr. 1108, datë 30.07.2008 "Për Miratimin e Listës së Inventarit të Pronave të Palujatshme Shtetërore të cilat kalojnë në Administrim të OSSH sh.a" dhe Ligjit Nr. 10116, Datë 23.04.2009, "Për Miratimin e Kontratës së Shitjes së 76% të Aksioneve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH sh.a) ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës së Republikës së Shqipërisë dhe CEZ a.s-së", si dhe cdo transferimi tjetër të kryer nga Korporata Energjitike Shqiptare sh.a. tek Shoqëria Operatori i Sistemit te Shpërndarjes sh.a,

Vendosi

1. Të miratoje transferimin e asetëve nga shoqëria Korporata Energjitike Shqiptare sh.a. tek Operatori i Sistemit te Shpërndarjes sh.a, miratimi i të cilave është bërë me VKM Nr. 969, datë 02.07.2008 "Për Miratimin e Listës së Inventarit të Pronave të Palujatshme Shtetërore të cilat kalojnë në Administrim të OSSH sh.a", VKM Nr. 1108, datë 30.07.2008 "Për Miratimin e Listës së Inventarit të Pronave të Palujatshme Shtetërore të cilat kalojnë në Administrim të OSSH sh.a" dhe Ligjit Nr. 10116, Datë 23.04.2009, "Për Miratimin e Kontratës së Shitjes së 76% të Aksioneve të

Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH sh.a) ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës së Republikës së Shqipërisë dhe CEZ a.s-së”, si dhe cdo transferim tjetër të aseteve të luajtshme dhe tëpaluajtshme nga shoqëria Korporata Energjitike Shqiptare sh.a. tek shoqëria Operatori i Sistemit të Shpërndarjes sh.a, nga momenti i kryerjes së cdo transferimi.

2. Ngarkohet Drejtoria e Juridike dhe e Mbrojtje së Konsumatorit për njoftimin e palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjehere.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Kryetari I ERE-s
Bujar Nepravishta
Ne mungese dhe me porosi
Ardian Haci